

VENDIM
Nr. 753, datë 23.9.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 682, DATË 29.7.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR
TRANSPORTIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË
NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës “ç”, të pikës 1, të vendimit nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) nxënësve që ndjekin procesin mësimor në institucionet arsimore publike, të arsimit të mesëm të lartë dhe të arsimit profesional, godinat e të cilave kanë dalë jashtë funksionit apo janë në rikonstruktion/rindërtim, vërtetuar me aktet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe që udhëtojnë mbi 5 km për të ndjekur procesin mësimor, larg vendbanimit të përhershëm.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe